

26

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.12/2017

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2289-4/2016 të datës 29.12.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Shpend Binaj dhe të akuzuarit, me datë 11.01.2018, publikisht morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**K [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR]** nga i ati **H [REDAKTUAR]** dhe e ëma **Z [REDAKTUAR]** e lindur [REDAKTUAR] i lindur më datë [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] tani me banim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën e mesme, vozitës i eskavatorit, i pa martuar, me numër personal [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Me datë 06.08.2016 rrethe orës 19:30 minuta, në Prizren rrugën "[REDAKTUAR]", si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik, shkel ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 61 të LSKRR, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës "Opel Agila", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], kur arrin në vendin kritik tek udhëkryqi i Lagjes "[REDAKTUAR]", nuk i respekton shenjëën e komunikacionit dritën e kuqe në semafor, me pjesën e përparme të automjetit e godet në pjesën e përparme automjetin e markës "Opel Zafira" me traga të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilin e drejtonte i dëmtuari **K [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR]** i cili ishte duke u kthyer në të majtë në drejtim të Prizrenit, ndërsa automjeti i markës "Opel Agila" pas goditjes nga inercioni ik në të djathtë dhe me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet fillimisht një mur betoni dhe pastaj godet shtyllën e betonit të rrymës elektrike dhe ndalet në rrugë, me ç'rast me këto veprime përveç dëmeve materiale në automjete, lëndime trupore marrin bashkudhëtarët në automjetin e akuzuarit të dëmtuarit: **Z [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR]** pëson ndrydhje në kokë, qafë, trup dhe në gjurin e djathtë, **A [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR]** pëson ndrydhje në të dy duart dhe **G [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR]** pëson ndrydhje në shpinë dhe në kyqin e shuplakës së këmbës së djathtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

**Këso dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, të akuzuarit i shqipton:

**D Ë N I M M E K U S H T**

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

2

Të dëmtuarit Z. [REDAKTUAR] (S. [REDAKTUAR]) A. [REDAKTUAR] (H. [REDAKTUAR]) A. [REDAKTUAR] e G. [REDAKTUAR] (H. [REDAKTUAR]) A. [REDAKTUAR], që të gjithë nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR] dhe K. [REDAKTUAR] (R. [REDAKTUAR]) S. [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

©bligohet i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës për ekspertin e komunikacionit 40.88 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko – ligjor për ekspertizë në shumë prej 50 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dëmit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 150 par.1 të LESP.

### A r s y e t i m


Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2289-4/2016 të datës 29.12.2016, kundër të akuzuarit K. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e ngritur ndaj të akuzuarit, i njëjti nuk e kundërshtoj provat dhe pranoi fajësinë për veprën penale objekt i akuzës.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 06.08.2016 rreth orës 19:30 minuta, në [REDAKTUAR] rrugën "[REDAKTUAR]", i akuzuari K. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik jetën e njerëzve dhe pasurinë, shkel nenin 49 dhe 61 të LSKRR, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës "Opel Agila", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] ku arrin në vendin kritik në udhëkryq tek Lagja [REDAKTUAR] nuk i respekton sinjalizimin ndriçues - shenjën e komunikacionit dritën e kuqe në semafor, me pjesën e përparme të automjetit e godet në pjesën e përparme të automjetit e markës "Opel Zafira" me traga të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilin e drejtonte i dëmtuari K. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR] i cili ishte duke u kthyer në të majtë në drejtim të Prizrenit, ndërsa automjeti i markës "Opel Agila" pas goditjes nga inercioni e godet murin e betonit dhe shtyllën e rrymës elektrike dhe ndalet në rrugë, me ç'rast me këto veprime përveç dëmeve materiale në automjete, lëndime trupore marrin bashkudhëtarët në automjetin e akuzuarit të dëmtuarit: Z. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] pëson ndrydhje në kokë, qafë, trup dhe në gjurin e djathtë, A. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] pëson ndrydhje në të dy duart dhe G. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] pëson ndrydhje në shpinë dhe në kyqin e shuplakës së këmbës së djathtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata para se të hap seancën fillestare – paraprakisht bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe bëri analizën e provave materiale dhe atë: raportin mjekësor i Spitalit Regjional në Prizren – Qendrës Emergjente me numër të protokollit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] të datës 06.08.2015, ekspertizën e ekspertit mjeko-ligjor Dr. M. [REDAKTUAR] G. [REDAKTUAR] datës 02.11.2016, ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Inxh. E. [REDAKTUAR] G. [REDAKTUAR] të datës 06.10.2016, skicën e vendit të ngjarjes si dhe foto dokumentacionin, me



Provata janë rast është vërtetuar se të gjitha provat janë marrë në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktakuzën e prokurorit të shtetit e bëjnë të qëndrueshme dhe e bazuar në ligj. Provat me kohë janë parashtruar të akuzuarit me qëllim që të njëjtat të ketë mundësi ti kundërshtoj dhe të parashtrorj prova të reja të cilat do të shkonin në favor të gjendjes faktike dhe mbrojtjes së tij. Mirëpo në seancën fillestare pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën e cila i vihet barrë, nuk i kundërshton provat me të cilat është ngritur aktakuza dhe e pranon fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK. Prandaj pasi që i akuzuari në seancën fillestare ka pranuar fajësinë dhe ky pranim është bërë vullnetarisht dhe pa asnjë kushtëzim, gjykata konsideroi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 246 të KPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin morri parasysh faktin se vullnetarisht ka pranuar fajësinë dhe ka treguar bashkëpunim me organet e drejtësisë, ka pasur sjellje korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjendja materiale dhe statusore - është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i familjes, kjo është hera parë që ka ra ndesh me ligjin, andaj duke u bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.


Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.12/2017 të datës 11.01.2018**

Procesmbajtësja  
 Myrvete Përdibuka




**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.